



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Nr.01 *060-62563/*2022

Dt: 05.05.2022

21.12.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më 05.05.2022, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00

Kryesuesi z.Zenun Elezaj përshëndeti të gjithë të gjithë antarët e KKSBS-se, ku theksojë që ky është takimi i parë bashkë dhe prezantoi rendin e ditës:

1. Prezentimi i planit të punës së KKSBS-së për vitin 2022
2. Siguria në Komunën e Klinës
3. Situata e lidhur me pandeminë/Covid19
4. Të ndryshme

1. Prezentimi i planit të punës së KKSBS-së për vitin 2022

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Besojë që tani i keni përpara planin e punës që është aprovuar në asamblenë komunale dhe që i parasheh të gjitha objektivat e nevojshme që ne duhet të merremi gjatë vitit 2022 dhe në qoftë se hapim debatin nëse dikush ka me shtu dicka rreth planit të punës, janë pra të gjithë objektivat dhe hapat të cilët janë të parapam sipas dinamikës kohore, nashta e di që është pak shpejt për juve me pa por është plan i punës i hartuar dhe i aprovuar në Kuvendin Komunal të Klina, po besoj që do të duhej ti përmbahemi po në qoftë se, Tunë Dedaj

z.Tunë Dedaj: Përshendetje kryetar për juve, përshendetje për nenkryetaren për drejtorin e arsimit për të gjithë të pranishmit. Plani është aprovuar në kuvend komunal dhe unë e përkrahi si të tillë, dua që gjatë këtij viti të punojmë në bazë të këtij plani dhe asnjë të keqe nuk ka, çdo gjë është në rregull por unë kërkojë të zbatohet pikë për pikë gjithmonë dhe të mos mungojnë përpjekjet tona.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Falenderojë Tunë Dedaj-n dhe pyet nëse dikush tjetër dëshiron ta mar fjalën dhe theksoj që janë përfshi të gjitha objektivat dhe pikat e nevojshme që duhet të trajtohen gjatë vitit 2022 por që kur kemi ndonjë rast nevojë për të diskutuar për dicka të caktuar sepse po flasim për dy

vitet e kaluara që kemi pasur pandeminë atëhere ose runa Zot ndonjë rast tjetër atëhere ne jemi te gatshëm të fusim në rend të ditës me kërkesë të anëtarëve të KKSB-së, po Hoxhë.

Hoxhë-z.Fitim Bojaj: Përshendetje kryetar përshendetje nenkryetare të pranishëm, edhe ne sa e morem planin e punës së KKSB-së katër vjekar dhe me sa e pava me shikim janë përfshirë gjitha ato, mirëpo sic the edhe ti mundemi që në vazhdimi me ndonjë ndryshim të vogël.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit mulla Fitim, po Elmi.

Z.Elmi Zenunaj: Përshëndetje te pranishmit edhe unë si Hoxha e kam një vërejtje se paraprakisht është dashtë na me punu rreth planit më heret praktikë ka qenë gjithmonë masanej është aprovu ne asamble, tash na sot e murrem planin e nuk jemi shumë në ngjarje çka ka ne detaje po siç that edhe ju me kohën mujm me ndryshu diçka tema të ndryshme, faleminderit.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit Enver, është një praktikë do të thotë po thuajse e ngajshme në të gjitha mandatet sepse edhe sekretaria pothuajse edhe duke ja shtuar problemet aktuale tani po nuk ndal, po Tunë.

z.Tunë Dedaj: Planin nuk e ban Këshilli, planin e ban Kryetari dhe e aprovon në kuvend do të thotë kjo nuk është punë që e ka lan Kryetari pa e ba kta po na nuk e bajmë na e zbatojmë këtë plan dhe jo ndonjë gjë tjetër, faleminderit Kryetar.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Unë thash që është ba thuajse me të njejtat specifika por specifikat I jep edhe koha nganjëhere nese ka nevojë me trajtu ndonjë temë ne jemi të gatshëm që ti futim në rend të ditës në takimet e radhës me kërkesë të anëtarëve të KKSB-së, sigurisht nenkryetarja do të jetë më e angazhuar por nuk do të mungoj edhe angazhimi im gjithmonë se ckado që të ketë nevojë të jemi bashkëmi kalu të gjitha kërkesat dhe sfidat e kohës. Unë u dasht me prezantu qe e kemi planin i cili është aprovuar ne asamblen Komunale realisht e lash në të ardhmen na me implementu këtë plan sipas të gjitha pikave të parapame, atëhere nese pajtoheni kalojmë në pikën e dytë te rendit të ditës, siguria ne komunën e Klines.

2.Siguria ne Komunën e Klines

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Komandanti i Policisë me gjasë po na vjen dhe do t'ja japim fjalën se është në hymje tash e pash, do ja jepim fjalën po na jemi këtu me diskutu qdo element që na shqetëson, unë mendoj se në komunën e Klines realisht gjatë këti intervali kohor, hajde Komandant mirësevjen, sigurisht jemi në pikën e dytë të rendit të ditës Siguria ne Komunën e Klines dhe ne kemi takime të rregullta që un si Kryetar i komunes se Klines i mbaj me të gjithë. Komandanti i policisë në katër vitet e kalume ka qenë një praktikë, ka përgaditë një raport ku na ka dërgu dhe e ka prezantu raportin para anëtarëve te kuvendit që ka qenë një moment i mirë rast i mirë moment që i është dhënë qdo anëtari të kuvendit me i shpreh të gjitha shqetësimet lidhur me sigurinë në Komunën e Klines. E di qe komandanti nuk është përgadit po në qoftëse nuk priton po besojë që konstatimi i përgjithshëm pa ja mohu të drejtën e cdo njerit me shprehë cdo si me thanë cdo shqetësim qe e ka të ndërlidhur me Komunën e Klines jemi bashkë po nese Komandanti ka dy tri fjale.

Komandanti i Policisë z.Ragip Bytyqi: Faleminderit kryetar, përshëndetje për të gjithë, unë fillimisht dua të kërkojë falje për vonesën ka qenë një arsye subjektive që unë nuk mujta me marrë pjesë dhe me tregu drejtë nuk jam i përgatitur me statistika që veç foli kryetari, por viti kalendarik 2021 statcioni policor Klinë ka përcjellë me një varg vepra të ndryshme penale, por marrë në përgjithësi situatën e sigurisë për vitin 2021ka qenë ndër qytetet me të qeta në zonën e Dukagjinit, për informacionin e juaj jemi për vitin e dytë me radhë sepse edhe në kuadër të drejtësisë rajonale të Policisë të ne bëhet njëfar gare në mes të stacioneve d.m.th është për vitin e dytë me radhë stacioni Policor në Klinë është shpallë si stacioni më i mirë ndërkaq unë si menaxheri më i suksesshëm, kështuqe është një inkurajim më i madh për me punu dhe me shku në drejtim të arritjeve të objektivave pak ma të mëdhaja. Sic e dini dy javët e fundit në zonën tonë të përgjithsisë me fatkeqësi muj me ju thanë i dini dy rastet shumë të rënda edhe kemi pasur dy jetë të humbura, prej fatkeqësive që kanë ndodhur është fatmirësi sespse të gjithë akterët e veprave penale që i kanë shkaktu këto vepra penale, gjithë akterët janë të arrestuar dhe vazhdojnë me qendru në paraburgim. Rastet kan përfundu nga ana jonë i kemi dërgu në prokurori, prokurori ka ba propozimet për përcaktimet e masava të caktuara sipas kodit penal mirëpo sido qe të jetë këto dy raste pak e kan godit nivelin e sigurisë në zonën tonë. Rastet e vjedhjeve, kemi raste te vjedhjeve sporadike muajin e kaluar i kemi pasur dikun afer aty në Zllakuqan i kemi pasur 3 vjedhje edhe ato vjedhje akoma nuk i kemi mujt me i ndricu po besojë që shumë shpejtë për ato vjedhje në fshatin Zllakuqan kemi ra në fjalë të mira dhe besojë që so ti arrestojmë edhe at kryes të atyre veprave penale. Po në terësi situata ne Klinë është e qetë në përjashtim të atyre dy rasteve qe i ceka më heret, faleminderit.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit komandant, nese dikush don me mar fjalen lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, Silvija.

z.Silvija Rashkoviç: Respekt për kryetarin, komandantin dhe të pranishmit në sallë, shkurtimisht lidhur me bashkësit pra komunitetet gjatë këtyre ditëve të festav i kemi pasur disa raste, jo dicka serioze, por një rast në fshatin Klinafca te Slobodan Llopaqani kan qenë disa sulme friksuese 7-8 ditët e fundit, kërkoj nga komandanti ti dërgojë disa përsona krysisht natën sepse sulmi ka ndodhur natën.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit, a janë raportuar këto raste në Polici.

z.Silvija Rashkoviç: Jo kjo familje qe e përmenda nuk kanë dashtë ta lajmërojnë policinë, sepse menodjnë që ata mund ti shkaktojnë vetës dëme më të mdhaja me lajmërimin e rastit. Sot unë i vizitova ata janë të frikesuar por nuk kanë parë kush kan qenë sulmuesit dhe nuk kan dasgur ti lajmërojnë por me kanë lajmëruat mua, thjesht ta dërgojnë patrullën natën.

Komandnti i Policisë z.Rgip Bytyqi: Këtë rast unë për herë të parë po e ndëgjojë dhe është do të thotë 22 vite pas luftës kohë e pasluftës ku liria e lëvizjes liria e shprehjes nuk i kemi probleme të kësaj natyre jo në Klinë po kësi problemi nuk e kemi as në nivel të drejtësisë rajonale. Unë personalisht nesër kur them personalisht do ta vizitojë këtë familja dhe cka ka mundësi për me ba për këtë familje, jo vetëm pë këtë famije por pë secilen familje vec e vec, do ta vizitoj dhe pësonalisht do të merrem me këtë problematikë, ndërkaq për sa i përket rastit të dytë që the për largimin e uzurpatorëve nëse egziston vendimi i plotëfuqishëm i uzurpatorëve normalisht qe na kemi edhe obligim moral mbi të gjitha kemi

obligim ligjor që me t'u përgjegjë dhe me i largu kryesit e veprave penale prej zonave ku i kanë ozurpu.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit Komandant dikush tjetër, Josip Dedaj.

z.Josip Dedaj: Faleminderit i ndruar kryetar, përshëndetje për ju, nënkryetaren, komandantin dhe të gjithë të pranishmit. Unë muj vetem me ju tregu për fshatin Dresnik që situata e sigurisë është shumë e kënaqshme tu e falenderu gjithmonë stacionin e Policisë këtu në Klinë të cilët me të vërtetë është stafi civil që kemi kontakte shumë shpesh me ta por edhe patrulla që patrollojnë shpesh edhe nuk ka asnjë rast që as edhe ma i lehti për me raportu për ta, si për siguri të qytetarëve dhe këmbësoreve që kalojnë drejt qytetit të Klinës. Problem numër një e kemi, që e kemi pas q disa vite e që ndoshta edhe në nivel të Kosovës po ne në Klinë e kemi një problem të qentë endacak do të thotë janë shumë rigoroz edhe rreziku është te femijët kua të vije Zoti na ruajt nga ndonjë kafshim ose dicka ndoshta me siguri do të jetë vonë. E kemi edhe një pasiguri edhe një problem qe me kryetarin e kemi diskutuar edhe ma heret te lumi ku është lumi Pusi i Jarinës që banorët e fshatit Dresnik kan toka përtej Klinafcit, aty jo qe kemi tentu dicka me ba një vendkalim ose një rrugë sa për traktor ose mjete punuese po aty është ba liqe, dikush nuk e di se kush e ka marrë atë guxim me hap aq lumin pa kurfar leje ose pa kurfar drejte. Me ardhë ju me pa aty se qysh është ba ai lum se far hijeshije ka pasë, dikush po thot që është për siguri të fabrikave për lumenj për rrezik por lumin qe po del ne fushë po ajo nuk egziston hic, atje dikun janë mbi 4hektar tokë që nuk janë tu mujt banorët mi punu, duhet me ardhë neper Klinë do te thot neper Dresnik e te stacioni i Policisë pë me punu psh 1parcellë 50 ari ose 40 ari nuk e di deri kur e kemi pas premtimin se ma me u ndreqë ajo rrugë, nuk jam tu thanë urë po vetem që kalon traktori ose mjetet punuese, as për automjete jo se skan qka me lyp automjetet në atë rrugë, është me të vërtetë unë kam edhe ankesa edhe prej amiljes Mataj edhe Dedaj edhe prej komunitetit serb qe kanë toka anej po që janë të pakalueshme, faleminderit.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit Josip, sigurisht qe qeshtja e parë e qenve endacak ka shqetësime të shumta edhe ndoshta unë nuk e di me saktësi dinamikën e planin po ndoshta do te duhej në një prej takimeve të radhës drejtorin e shërbimeve publike për me na dhanë një informatë ma të saktë, por informatat që i kam na kemi lidh një kontratë, nashta jemi një prej komunave të vetme qe kem edhe vitin e kalum besoj se kush ka qenë anëtar i KKSb-së e ka informatën dhe po i trajtojmë qentë me ato mundësitë qe janë të parapame me kontratë, komuna e Klina do të thot që nga viti nese nuk gaboj tash një vit dikun e kemi kontarten e lidhur me një kompani profesionale e cila i trajton qentë endacak, por edhe nga takimi me te gjithë kryetaret e komunave në asosacionin e komunave ky ka dal te jetë një problem më i komplikuar sepse shpesh here kompanitë qe i trajtojnë qentë nga një komunë i marrin dhe i bartin në komunën tjetër, është problem i njoftun edhe për policinë e Kosovës, për qeverinë e Kosovës, dhe qeveria jo kjo qe është tani por qeveria e kalume ka pas një projekt në gjithë Kosovën. Unë mendoj se ajo ka qenë një ide më e mirë ka qenë një projekt ku agjensioni i veterines së Kosovës e ka udhëheq dhe e ka financu nga buxheti i Republikës se Kosovës dhe ka pas mundësi mi trajtu ka pas mangësi shumë sepse komunat kan pas kompetenca pak po që mendoj qe ka qenë një projekt i mirë sepse i njejt operator e ka pas kompetencën në krejt Kosovë dhe do te thotë që qentë endacak nga një komunë ne komunën tjetër nuk mund me u asryetu, po shihet edhe komuna e Prishtinës me far probleme në të njejtën kohë jemi edhe ne, por qe ne mund të trajtojmë vetem në kuader të kontratës të cilën e kemi me një operator dhe besoni qe të gjithë keta qenë qe janë, janë te trajtuar dhe supozohet që janë te qetë por në momente te caktume problemet po praqiten dhe janë evidente, nuk do të ishte keq qe ne

një prej takimeve tjera ta kemi drejtorin e shërbimeve publike me të dhënat konkrete ashtu sic ndoshta do të duhej pak kohë që jo në muajin e ardhshëm po në takimin ai të them jo në takimin e radhes po takimin tjetër ta kemi por nese doni si rekomandim mund të japim që në takimin e ardhshëm ta kemi drejtorin e shërbimeve publike me të dhëna konkrete. Ndertimi i ures në Dresnik ka qenë e vërtetë ka qenë edhe premtim i imi, ky vit që jemi sivjet është një vit i vështirë financiar duke pas parasysh situatën që e kemi trashëgu edhe nga pandemia por kryesisht si pasojë e zhvillimeve të fundit në Ukrainë, unë i kuptoj qytetarët kom dëgju edhe një rast psh në Top Chanel ku thot qepa po rritet në Korcë lufta në Ukrainë e pse me u rrit cmimi, por cmimet në kemi problem me rifillimin e kontratave 2 vjecare që kemi pas vitin e kalum edhe këtë vit, asnjë kompani nuk mundet me i'a fillu kontates sepse cmimet janë dyfishu. Mundesi ligjore nuk kemi me i rrit cmimet dhe vetem shpetimin e shofim në zhvillimin e procedurave të reja në qoftëse kemi parapa me i shtru 3km rrugë në një fshat me procedura të reja mund ti shtrojmë vetem 1,5 km prej 3,000m gjatësi 1,500m do të thot komplet është e dyfishume. Permes shqetësimeve që i kemi prezantu kryetaret e komunave permes asosacioneit të komunave të Kosovës kemi kerku nga qeveria të ketë rritje të vlerave të kontratave egzistuese, ka premtime dhe vetem ajo shifet si një mundësi me të cilën mund të fillojmë projektet flas për projektet që janë dy vjecare nga voto i kalum dhe këtë vit edhe në fillimin e procedurave të prokurorimit këtë vit kemi probleme sepse të gjitha ofertat që janë dhanë janë mbi vlerën e parashikume tu pasë parasyshë gjithmonë rritjen e cmimeve në treg dhe jemi në një situatë ku nuk kemi mujt me shpenzu buxhetin për shkak të këtyre problemeve tani po veprojmë edhe në konsultime me kompani dhe konsultime me cmimet e tregut do të thot edhe në po duhet me i rrit cmimet por rastin që e dha Josipi unë e dhash një përkshkrim ma të gjanë sa për të ju informu ju ndersa rasti që e flet Josipi ta shohim mundësinë ose kemi një buxhet të vogël për në atë pjesë të paktën besojë që dikush nga ne do ta viziton bashkë me banorë që të paktën me vendosjen e disa gurëve të minuar t'jau mundësojmë banorëve të asaj pjese me kalu me mjete bujqesore me kalu prej njanës anë në anën tjetër të lumit, faleminderit.

Hoxha -z.Fitim Bojaj: atëhere përshendetje edhe njëhere, për situatën e sigurisë edhe në bashkangjitemi komandantit të policisë që të gjithëve na kanë prekur të dy rastet që kanë ndodhur muajit e fundit prandaj shprehim ngushllimet dhe lusim Zotin e madh që mos të ndodhin kështu kurr ma. Në vendin tonë situata e sigurisë është e qetë stabile lëvizese mirëpo unë këqyra pak planin e punës kështu, ajo cka na shqetëson juve dhe neve është përdorja e narkotikeve për fëmijë këtu qenka edhe komandanti i policisë këtu qenka edhe drejtori unë kisha propozu i pam disa objektiva dhe disa aktivitete këtu siguria në shkollat fillore dhe të mesme pastaj mbajtja e ligjeratave në shkollat në shkollat të komunës nga ekspert të mjeksisë

pastaj mbajtja e ligjeratave nga policia, unë kisha propozu që nganjëhere në këto ligjerata të marim pjesë edhe bashkësitë fetare dmth të jemi bashkë me policinë të jemi bashkë me DKA-në të jemi bashkë me drejtorinë e shëndetësisë se kjo është në të mirë të fëmijëve tanë të prezantojmë edhe për bashkësitë fetare gjitha bashkësitë fetare ku edhe me ligjerata të vetëdijesojmë fëmijët tanë për arsye tash edhe policia e dinë ma shumë ama shpërndarja e narkotikeve është ka shpërndahet me të madhe si të shkollat fillore "Ismet Raci" ashtu edhe të shkollat e mesme, prandaj kisha kerku me pas seriozitet në këtë drejti, policia me i shtu patrollat ma shumë dhe mos të lajmë fëmijët tanë të shkojnë, për arsye se dikur ndoshta edhe asht vonë. Unë i pava disa këtu psh dhënia e ndihmës e atyre që kanë përdor narkotik, ma mirë është parandalimi i përdorjes së dhënia e ndihmës kur ata e marrin.

Kryesues z.Zenun Elezaj: Faleminderit Hoxhë, besojë që ky është një shqetësim që na preokupon të

gjithëve dhe do të duhej që se bashkëpunimi i qytetarëve të jetë në nivel të duhur me organet e rendit në mënyrë që organet e rendit i kan edhe të dhënat e tyre përvec atyre që përmende besoj që policia i ka informatat në qoftë se dicka zhvillohet por atë që e kerkojë unë nga qytetaret e komunes se Klinës të jenë bashkëpunues shumë me policinë e e Kosovës të japin informata dhe nuk do të mungojë as angazhimi i policisë po pse jo edhe permes këtyre programeve edukuese parandaluese që tha hoxha, ke të drejtë sepse ja vlen me investu në parandalimin edhe nashta shumë ma pak në metodat tjera që i luftojnë nashta pasojat, po komandant.

Komandanti Policisë z.Ragip Bytyqi: Kryetari e din që na muajin e fundit i kemi shtu aktivitetet ndaj shkollave sepse sipas informacioneve që i kemi pranë ka qenë shqetësuese kjo dokuri mirëpo në baza ditore i kemi angazhu zyratet policor civil neper shkolla, bëhet kontakti me personelin adekuat neper shkollamirëpo gjendja në teren nuk i tregon kvto informacione, sepse në bazë të atyre informacioneve që kemi ka qenë shumë shqetësuese sepse edhe ne e kemi atë zyren e analizave që i marim informacionet, kemi ba analiza dhe në bazë të atyre analizave kemi dalë me disa olane konkrete mbi parandalimin, mirëpo gjendja faktike në teren nuk është duke i argumentuar ato informacione që na i kemi perpunu dhe i kemi analizu normalisht që ne po thuajse në baza mujore mbajmë ligjerata nëpër shkolla dhe prej temave me të ndryshme, një ndër temat është edhe parandalimi i narkotikëve tek moshat e reja ku tek ne është personi adekuat i profesionalizuar për mbajtjen e këtyre ligjeratave ne bashkarisht me drejtorinë e DKA-së këto ligjerata qdo here i mbajmë në bashkëpunim bile të disa tema të fundit që i kemi, kemi kërkim fuqishëm të na përkrahin edhe e disa psikolog sepse dy shkollat e Klinës këtu i kan edhe psikologët e shkollës të cilët n kan mbeshtetur gjatë gjithë ligjeratave e pse jo edhe në këtë formë që ju vec e dhat si ide, e ide e cila besoj që la me gjet përkrahjen sepse kjo ide e juaja ka dicka pozitive edhe ne asht mirë mu marë me parandalimin e jo me masë progresive masi të ndodhin dokurit, kështuqë unë këtë temë këtë pikë cka ju e that nuk muj me vendosë vet sepse për mbajtjen e ligjeratave me kreret fetar duhet me mar araparakishht edhe një leje për me marë pjesë ju në ato ligjerata po është dicka që realizohet.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit komandant, Tunë vetem po shtojë dicka vet, po besojë që meqenëse e kemi këtu edhe radio Alben do të ishte e rrugës edhe ne interes të tyre do të ishte ta realizonin një debat në radio me njerëz që mujnë me kontribu. Kuptohet me përzgjedhjen e moderatorit sepse por unë kisha sygjerru që të ketë emisione edhe të kesaj natyre sepse të gjithë na jemi të shqetësuar të gjithë kemi të dhana kemi informacione po policia është ajo po edhe stafi mësimdhënës por policia është ajo që është e angazhuar as sa mundet por bashkëpunimi i qytetarëve duhet të jetë ajo që i ndihmon që me i gjetë se k ka konsumim, Tunë.

z.Tunë Dedaj: Po kryetar faleminderit shumë, unë kisha me falemnderu shumëkomandatin e policisë edhe policinë e komunes se Klina, edhe na e kemi një gjendje të sigurisë shumë të mirë në komunë, sa i përket një rasti që ka ndodhur në Klinë unë personalisht tham se ish kan mirë me lajmëru policinë e Kosovës, unë psh sot këti rasti nuk i besojë se ata kan mujt me qenë hajna që i thejnd edhe shpjat e Shqiptarëve nuk i thejndë vec shpijat e serbeve, romëve apo dikujt tjetër kan mujt me qenë hajna, ka qenëshumv mirëme lajmëru policinë se policia ndoshta në mënyrë automatike e kishin zbulu rastin. Rreth trajtimit të qenëve endacak që bahet unë kurrë s'kam mu pajtu, se nuk po bahen trajtime dhe nuk asht zgjidhje trajtimi se qeni e han fminë tu shku në shkollë, qentë jan tu na ba dame edhe në bujqësi sa sot e dim, duhet rreth 1,000 euro me mjellë 1 hektar grun, besoni unë vet në ara të mija kur i shoh ose te

kojshitë kr i shoh 10 qenë 1 hektar grun ta prishin se perdit tu tu sjellë grunit, nuk është zgjidhje po kta u dasht me ba qeveria e Kosovës qoftë ajo me nda mjete edhe te pesëfishume se sa kanë nda mi mar mi trajtu mi majt ose me ba një zgjidhje me ta, përpara une sot i kam 64 vjet përpara u ba eleminimi i qenve u ba në krejt boten nuk u ba vetem këtu, ateher une kaq pata.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit Tunë, Elmi

z.Elmi Zenunaj: Përshendetje, deshta një vërejtje këtu në kuader ku e kemi vendosja e shkallëve emergjente në objekte, kërkohet leja e ndertimit, unë kisha kërkun te angazhohet inspeksioni dhe në objektet e ndërtuara që janë me leje ndërtimi të vendosen shkallët emergjente, jo vetem ato që ndertohen në të ardhmen edhe atyne me jau kushtëzu qe duhet se është obligim ligjor shkalla emergjente me ni objekt 5 kat e ndertume, komuna 3 kat kemi shkallet emergjente psh jo vetem ata qe ndertojnë në të ardhmen po edhe kta qe kan ndertu me jau kerku lejen e shkalleve emergjent, me i angazhu inspektorët dhe ish kry kjo punë, një kontroll me zyrtarët e preventivës.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit Elmi po besojë qe është mirë ne të ardhmen dhe besojë qe ne të ardhmen nuk nshojnëleje pa i pas në projekt edhe shkallët emergjente mirëpo ide e mirë që të përfshihet në procesverbal që inspektoriat ta bejë një kulumtim dhe nese ka edhe pse unë besojë qe nuk ka po nëse ka dihet kudo që është të dërgohen vërejtjet dhe afatet për vendosjen e këtyre shkallëve.

Dikush tjetër, faleminderit shume po kalojmë në pikë e tretë të rendit të ditës.

3. Situata lidhur me pandeminë ose Covid19

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Ne nuk kemi përgaditur ndonjë të dhanv të specifikuar por unë nv punën përshkruese po jap sepse ne në komunë e kemi te themeluar edhe shtabin emergjent për menagjimin e situates me Covid dhe mund t'ju them se situata është e qetë nuk kemi raste, kemi pasur ndonjë rast sporadik do të thot në javë një rast dy dhe të cilat po kalojnë me simptoma te lehta, ka qenë shqetësuese kohae vitit të ri kur kemi pasur shumë bashkëatdhetarë por të ju them te drejten edhe aty ka pasur rritje shumë shumë të lehtë dmth ka pas pak raste që janë menagju me sukses edhe fal angazhimit të QKMF-së punonjësve të qendres kryesore të mjeksisë familjare në Klinë por edhe të gjithë stafit shendetsorë edhe ati privat sepse ne këtë rast në luftë kunder pandemisë kan qenë të gjithë mantilbardhët në komunën e Klinës dhe padallim në momente të caktume ka pasur edhe situata të komplikuar ose ngarkesë pvr të gjitha këto institucione po mendojë që është menagju mirë dhe është tejkalu kjo situatë tani ma ka sinjale te hjekjes se ndalesave sic dihet jan hekë disa ndalesa qe kanë qenë përpara n masat e vendosuar nga qeveria e Kosovës dhe pothuajse këto ditë jemi qetë dhe nuk po shohë ndonjë shqetësim, nuk kemi takime të shtabit emergjent sepse situata është e menagjueshme dhe ka pothuajse zero raste. Nese dikush ka me u kyq për këtë pikë, Josip.

z.Josip Dedaj: I kisha lan edhe te ndryshme zoti kryetar po deshta vetem me jau rikujtu 4 vjet e kalume komandanti u kanë cdo here prezent dhe qita zotni e zonja qitu për shenjat e komunikacionit në qytetin e Klinës. Unë i kam cekë disa pika ku me të vërtetë janë pika të rrezikshme dyjanë ne sheshin e "Nue Përlleshit" nuk ka shenjë të kryqezimit, rrugë një kahje ka rruga e Sfer Manve nuk ka shenjë që është rrugë nj kahje policët kan dhanë tiketë aty e qytetarët jan denu pa shenja komunikacioni, rrethi "Faruk

Elezi” nuk ka kryqëzim të rrugës në hyrje të ambulantes, këto shenja nuk kanë egzistuar asnjehere do të thotë që 4 vite rresht unë nuk kam takim që nuk e kam përmendur për këto shenja dhe nuk kam lan ditë pa than se duhet me dalë dhe me i rregullu, nuk e di pse bile e din Shemsia njëherë me pat thanë që je edhe ti në komision unë nuk e kam ditë që jam aty. Njëherë kemi dalë me Ibrin dhe Petritin edhe ma kurr mëna 4 viteve është fjala, jemi në 2022-en deri kur qyteti i Klinës don me kan pa shenja. Me dal neper fshatra na kemi pas para 4/5 viteve një aksident me tren në fshatin Gjurgjevik i Madh ose Dush me katër persona të vdekur përshkak se nuk është shenja e kryqëzimit të hekurudhës, i kam qit edhe do shenja nëper hekurudha, 5m para hekurudhës ajo është 250m përpara njoftimit nuk e di a kem na kushte a kem na njerëz që mujnë mi vendosë ato shenja spaku në komunën e Klinës janë 20 inzhinjerë të komunikacionit e janë nja 20 inspektorë që janë me të vërtetë shumë njerë të përgaditur e që mujnë me kry këtë punë ma mer menja që nuk e mbrinin shifren e 2,000 euro mi qit edhe neper fshatra këto shenja, kaq.

Kryesuesi z.Zenun Elezaj: Faleminderit Josip do të thotë në kalim në pikën e katër të ditës të ndryshme që është një shqetësim i Josipit edhe sigurisht që edhe procesverbali do të mbahet do të jetë obligim për drejtorinë e inspektoriatit e cila merret me këtë qeshtje besojë që është e nevojshme me i shiqu, u përmenden ehe nga Josipi vendete specifike po mirë është edhe me u taku le të mbetet në procesverbal që ky komision që edhe unë spo e di saktë se kush është, po të takohet sigurisht dikush do të jetë nga policia dhe nga drejtoria e inspektoriatit apo kushdo qoftë, është mirë me u taku edhe me u marë me këto shqetësime sepse vendosja e shenjave është parandalimpër fatkeqësi dhe besojë që e kemi obligim ligjor që në komunën e Klinës të paktën ti kemi shenjat sepse kur vjen momenti apo e bjen dikush tjetër por na ta parandalojmë me vendosje e shenjave.

Dikush tjetër jemi në pikën në të ndryshme. Nese nuk ka faleminderit shumë për këtë takim dhe kush është për nga një kafe masi është takimi i parë e kemi me borxh ka një kafe me qit, ramazan nuk është haha. Faleminderit shumë shihemi në takimin e radhës.

Procesmbatësi,

Orgeta Sylaj

Kryesuesi,
Zenun Elezaj

